

## Vendim nr. 2 datë 03.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 03.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (V) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **VJOLLCA BURIMI**, përfaqësuar me deklaram nga avokat Islam Llapi

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5292 (750), datë 18.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Vjollca Burimi dhe ish-bashkëshorti i saj, E.B., kanë pasur në bashkëpronësi pasurinë e paluajtshme të llojit “njësi”, me sipërfaqe 248.16 m<sup>2</sup>, e cila ndodhet në zonën kadastrale

nr. 8160, Tiranë. Nëpërmjet kontratës së shitjes nr. 4029 rep. dhe nr. 672/1 kol., datë 07.08.2007, ata i kanë shitur 1/2-ën e kësaj prone shtetasve Th.B. dhe R.B. në pjesë të barabarta 1/4-ën e pronës secili. Për këtë arsye, në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë (ZVRPP-ja, Tiranë) kanë rezultuar bashkëpronarë mbi këtë send të paluajtshëm shtetasit Th.B. dhe R.B. me 1/4-ën pjesë të sendit secili, si dhe kërkuesja e ish-bashkëshorti i saj në 2/4-at pjesë.

2. Në datën 12.03.2008 ish-bashkëshorti i kërkueses, në cilësinë e “shitësit” dhe Th.B., në cilësinë e “blerësit”, në prani të kërkueses, e cila ka dhënë pëlqimin për shitjen e pasurisë së paluajtshme, kanë nënshkruar një “Kontratë kapari” me nr. 2671 rep. dhe nr. 390/2 kol., datë 12.03.2008. Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se palët kanë rënë dakord që shitësi do të shesë dhe blerësi do të blejë 1/2-ën pjesë të një njësie prej 248.16 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë. Në nenin 2 të kontratës përcaktohet se blerësi i ka paguar shitësit, përpara nënshkrimit të kësaj kontrate në prani të noterit, shumën prej 191.600 eurosh si kapar për të siguruar blerjen e pjesës së sipërpërmendur. Ndërsa në nenin 3 përcaktohet se çmimi real total i blerjes së 1/2-ës të sipërfaqes së sipërpërmendur është 250.000 euro, por palët pranojnë që kontratën përfundimtare të shitjes ta bëjnë me çmimin referues zyrtar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate kapari që është 37.844.400 lekë; kapari i paguar prej 191.600 eurosh do të zbritet nga çmimi total, në momentin e blerjes përfundimtare, duke mbetur për t’u paguar shuma prej 58.400 eurosh. Në nenin 4 përcaktohet se kontrata përfundimtare e shitblerjes do të kryhet menjëherë me sigurimin e dokumenteve përkatëse të pronësisë dhe pagimit të këstit të dytë dhe të fundit, brenda dhe jo më vonë se 31 dhjetor 2008, dhe se palët kontraktuese do të nënshkruajnë kontratën përkatëse ligjore brenda këtij afati ligjor.

3. Në vijim, nëpërmjet deklaratës noteriale nr. 544 rep. dhe nr. 72/2 kol., datë 27.01.2009, ish-bashkëshorti i kërkueses, me cilësinë e shitësit, ka deklaruar se ka marrë të gjithë çmimin e shitjes së pasurisë, objekt i kontratës së kaparit të sipërpërmendur, në një shumë totale prej 58.000 eurosh dhe se nuk ka asnjë pretendim tjetër financiar për këtë shitje. Po kështu edhe blerësi Th.B. ka deklaruar se ai është plotësisht dakord me këtë deklaram.

4. Me vendimin nr. 4861, datë 14.06.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është zgjidhur martesë midis kërkueses dhe bashkëshortit të saj.

5. Shtetasit Th.B. dhe R.B., duke qenë se nuk kanë mundur të lidhin kontratën përfundimtare të shitjes, sikurse kishin rënë dakord me kontratën nr. 2671 rep. dhe nr. 390/2 kol., datë 12.03.2008 “Kontratë kapari”, i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi ndaj kërkueses dhe ish-bashkëshortit të saj me objekt detyrimin e të paditurve të njohin paditësit pronarë për sipërfaqen

124.08 m<sup>2</sup> që përbën ½-ën (pjesën e bashkëshortëve) e të gjithë pronës, duke u bërë paditësit bashkëpronarë të vetëm të pronës prej 248.16 m<sup>2</sup>, si dhe regjistrimin e kësaj prone vetëm në emër të dy paditësve, në pjesë të barabarta.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11379, datë 26.11.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë; detyrimin e të paditurve të njohin paditësin Th.B. pronar për ½-ën pjesë të pasurisë së paluajtshme të llojit njësi, me sipërfaqe 124.08 m<sup>2</sup> dhe rrëzimin e kërkesëpadisë për paditësin tjetër R.B., si të pambështetur në prova. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuësja.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2468, datë 03.12.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs ish-bashkëshorti i kërkuëses dhe pala paditëse Th.B.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5292 (750), datë 18.12.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se gjykata e apelit nuk ka interpretuar drejt ligjin e zbatueshëm, ndërsa gjykata e shkallës së parë e ka zgjidhur drejt mosmarrëveshjen, ndaj vendimi i saj duhet të lihet në fuqi.

9. Në datën 13.11.2024 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kriterëve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 25.11.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuëses

10. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

10.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Civil e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit duke ndryshuar vendimin e gjykatës së apelit pa u dëgjuar kërkuësja. Qëndrimi i ndryshëm i dy gjykatave të faktit e bënte të domosdoshëm shqyrtimin në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve, ku duhet të parashtroheshin pretendimet dhe mendimet e tyre. Për më tepër, çështja e kërkuëses është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2017, pra kanë kaluar 7 vjet pa asnjë veprim.

10.1.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në datën 03.05.2017 ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore, ndërsa

në datën 20.11.2023 po i njëjti kolegji ka revokuar vendimin e mëparshëm duke e kaluar çështjen për shqyrtim në dhomën e këshillimit, pa dhënë arsytet e kësaj vendimmarrjeje.

10.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë në mënyrë antiligjore ka vlerësuar se kontrata e kaparit është kontratë shitjeje, kur kontrata e kaparit përcakton kushtet për realizimin e kontratës së shitjes. Kontrata e kaparit rregullohet me dispozitë tjetër nga ajo e shitjes. Po kështu, kjo gjykatë nuk arsyeton fare në lidhje me afatin kur është kryer pagesa e fundit prej 58.000 eurosh dhe anashkalon edhe faktin se pagesa e kështit të fundit është kryer vetëm në prani të ish-bashkëshortit të kërkueses dhe paditësit në datën 27.01.2009 pa u njoftuar kërkuësja. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur parasysh në vendimin e saj deklaratën noteriale të vitit 2009, e cila është nënshkruar pa dijeninë e kërkueses.

10.2. *Të drejtën e pronës*, pasi paditësi në gjykim dhe ish-bashkëshorti E.B. kanë kryer veprime juridike fiktive për të shmangur kërkuesen nga bashkëpronësia dhe për t'i mohuar të drejtat mbi pasurinë objekt konflikti.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në këtë këndvështrim, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton afatin ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuësja është dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në datën 18.12.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 13.11.2024, pra jashtë afatit ligjor 4-mujor. Për qëllime të këtij shqyrtimi i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Sipas informacionit të përcjellë në rrugë elektronike, Gjykata e Lartë ka konfirmuar se vendimi objekt kundërshtimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 03.05.2024, datë në të cilën është bërë i disponueshëm për palët.

16. Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, Kolegji vëren se kërkuësja ka parashtruar se ajo është njohur me vendimin pasi e ka tërhequr në sekretarinë e Gjykatës së Lartë në datën 07.10.2024, pa dhënë ndonjë argument për të shpjeguar ekzistencën e shkaqeve ose rrethanave që mund ta kenë penguar për marrjen dijeni me vonesë të vendimit.

17. Në analizë të këtyre rrethanave, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuësës në lidhje me momentin e marrjes dijeni për vendimin e kundërshtuar nuk është i mjaftueshëm për të provuar në nivel kushtetues se data e pretenduar prej saj duhet të konsiderohet si data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e kundërshtuar. Në këtë kuptim, bazuar në standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji çmon se kërkuësja konsiderohet të ketë marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë ditën e publikimit të vendimit, më 03.05.2024. Paraqitja e vendimit gjyqësor me shënimin e datës kur është tërhequr nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht prej kërkuësës, për shkak se një shënim i tillë mund të vendoset nga sekretaria gjyqësore në çdo rast dhe në çdo kohë që një palë ndërgjyqëse paraqitet për të tërhequr kopje të vendimit gjyqësor.

18. Nga sa më lart, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, kërkesja nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues dhe, për këtë arsye, nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kritereve të tjera të pranueshmërisë së kërkesës.

19. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.